



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prijimeno / Predato Received / Delivered	16-02	2021	1	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Mjesia Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SADRŽAJNIK 682/2021				9/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.430/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.430/2020 të datës 21.12.2020 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë Lagjja "Nic" Rr. Bekim Fehmiu - Çagllavicë -Prishtinë, kundër organit të punësimit Zyra e Presidentit, në çështjen juridike "pezullim nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 15.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.430/2020 e datës 21.12.2020 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anullohet** Vendimi Nr.234 i datës 15.12.2020, si dhe pika 3, 4 dhe 5 e Vendimit Nr.237/2020 të datës 22.12.2020 të U.d Presidentes të Republikës së Kosovës.
- III. **Obligohet** U.d Presidentja e Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin \_\_\_\_\_ në pozitën e Sekretarit të Zyrës së Presidentit, sipas Vendimit me Nr.85/2018 të datës 18.06.2018, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e pezullimit nga marrëdhënia e punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

U.d Presidentja e Republikës së Kosovës, me datë 15.12.2020 ka nxjerr Vendimin Nr.234 përmes të cilit ankuesin Driton Gashi e ka pezulluar nga pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentit, me 50% të pagës, për shkak të dyshimit për shkelje të rendë të detyrave të punës.

Kundër Vendimit Nr.234 të datës 15.12.2020, ankuesi brenda afatit ligjor me datë 21.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 3245/2020, të regjistruar me numër A.nr.430/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 24.12.2020, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Zyra e Presidentit të Republikës se Kosovës. Këshilli me datë 05.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoll 3245/2020 të regjistruar me numër Anr.430/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin numër 733/1 të datës 29.06.2018; Vendimin Nr.234 të datës 15.12.2020; Rregulloren Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës; Vendimin Nr.237 të datës 22.12.2020; Shkresën me numër protokoll 1369 të datës 24.12.2020; si dhe Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 06/2021 të datës 05.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 18.06.2018 përmes Vendimit me Nr.prot:733/1 të Presidentit të Republikës se Kosovës, është emëruar Sekretar i Zyrës së Presidentit, sipas dispozitave të nenit 14 paragrafi 5 dhe nenit 16 të Ligjit Nr.03/L-194 për Presidentin e Republikës se Kosovës.

U.d Presidentja e Republikës se Kosovës, me datë 15.12.2020, përmes Vendimit Nr.234, ka pezulluar ankuesin nga pozita e Sekretarit të Zyrës se Presidentit, me 50% të pagës, për shkak të dyshimit për shkelje të rëndë të detyrave të punës, deri në përfundimin e procedurave për shkelje të supozuara.

Kundër Vendimit Nr.234 për pezullim nga puna, ankuesi brenda afatit ligjor me datë 21.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se Vendimi Nr.234 është nxjerr në kundërshtim me ligjin material dhe në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, si dhe është shkelur parimi i ligjshmërisë si rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.12.2020 përmes përgjigjes në ankesë me numër protokoll 3315/2020, ka pranuar nga Zyra e Presidentit njoftimin se Vendimi Nr.234 është shfuqizuar me Vendimin Nr.237/2020 të datës 22.12.2020, duke ia bashkangjitur të njëjtin shkresave të lëndës. Nisur nga ky njoftim, Kolegji ka analizuar Vendimin Nr.237/2020 të datës 22.12.2020, dhe si rrjedhojë vlerëson se ka kundërthënie në mes të arsyetimit dhe dispozitivit të këtij vendimi, sepse me pikën 1 të dispozitivit shfuqizohet Vendimi Nr.234/2020 i datës 15 dhjetor 2020, ndërsa arsyetimi i referohet vetëm korigjimit të preambulës dhe pikës 4 të Vendimit Nr.234/2020 të datës 15 dhjetor 2020, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të këtij vendimi. Mirëpo duke iu referuar preambulës se Vendimit Nr.237/2020 të datës 22.12.2020 ku shihet se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes se këtij vendimi nuk i është referuar nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, por i është referuar nenit 50

të këtij ligji, dispozitë kjo e cili rregullon çështjen e korrigjimit të gabimeve të aktit administrativ, Kolegji konstaton se Vendimi Nr.237/2020 i datës 22.12.2020 ka të bëjë vetëm me korrigjim të gabimeve teknike dhe nuk e prek efektin juridik të pezullimit me c' rast edhe objekti i ankesës ka mbetur i njëjtë, kështu që vendosi t'i trajtoje pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me pezullimin nga puna në kontekst të Vendimit Nr.234 të datës 15.12.2020, si dhe duke marr për bazë edhe korrigjimet e bërë me Vendimin Nr.237/2020 të datës 22.12.2020.

Kolegji, me rastin e trajtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar Aktgjykimin me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën 211 të aktgjykimin ka konstatuar se: ... *Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë sa nuk cenon funksionet dhe organizativat e Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi*, andaj, si rrjedhojë Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e nenit 32 paragrafi 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 15 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentit hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se vendimi për pezullim e tij nga puna është në kundërshtim me ligjin material, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka analizuar dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku në mënyrë taksative janë përcaktuar rastet kur një nëpunës civil pezullohet nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar së nëpunësi civil për shkelje të detyrave të punës mund të pezullohet vetëm nga Komisioni Disiplinor, siç parashihet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 48 paragrafi 5, ku përcaktohet se: *Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenon ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar*. Përfundimisht në rastin e inicimit të procedurës disiplinore, ku kompetent për pezullimin e nëpunësit civil është Komisioni Disiplinor, në të gjitha rastet tjera të përcaktuara në dispozitat e nenit 56 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, kompetent për konstatimin e shkakut të pezullimit për nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues, në institucionet tjera shtetërore, është Njësia e Burimeve Njerëzore e atij institucioni, kështu që Kolegji vlerëson se Vendimi Nr.234 i datës 15.12.2020, si dhe pika 3,4 dhe 5 të Vendimit Nr.237/2020 të datës 22.12.2020 për pezullimin e ankuesit nga pozita e Sekretarit të Zyrës së Presidentit, nuk janë në përputhje me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, si dhe nenin 48 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj si rrjedhojë pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi Nr.234 i datës 15.12.2020 për pezullim nga detyra, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, Kolegji duke marr parasysh se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative, ka shqyrtuar pretendimin ankimor dhe vlerëson se Vendimi Nr.234 i datës 15.12.2020 është në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht vendimi nuk përmban pjesën përmbyllëse apo këshillën ligjore lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike, si element i detyrueshëm i aktit administrativ, po ashtu, vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 si dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.430/2020**

**Rushit KAJTAZI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Ardita Haxhnikaj - Dëmi**  
**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- U.d Presidentes të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidentit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

